



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4107/1 Prot.

Tiranë, më 30.06.2025

URDHËR

Nr. 288, datë 30.06.2025

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të urdhrin nr. 113, datë 26.03.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Ana Kapaj” të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e statutit të Universitetit European të Tiranës, sipas propozimeve të vendimit nr. 1/1, datë 19.05.2025 të Bordit të Administrimit dhe vendimit nr. 2/1, datë 21.05.2025, të Senatit Akademik, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri, 36 (tridhjetë e gjashtë) faqe.
2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të Universitetit European të Tiranës, të miratohen në zbatim të statutit dhe kuadrit ligjor në fuqi.
3. Statuti i Universitetit European të Tiranës miratuar me urdhrin nr. 90, datë 28.2.2017 të ministrit të Arsimit dhe Sportit, shfuqizohet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti i European i Tiranës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ





## STATUTI I UNIVERSITETIT EUROPIAN I TIRANËS

### KREU I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

###### Baza ligjore

1. Universiteti Europian i Tiranës, i quajtur këtu e në vazhdim duke përdorur akronimin "UET", e ushtron aktivitetin bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. UET është krijuar me VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Europian i Tiranës". Me VKM Nr. 657, datë 28.09.2011, emërtimi i institucionit është ndryshuar nga "Shkolla e Lartë Universitare Jopublike Universiteti Europian i Tiranës" në "Universiteti Europian i Tiranës". Njësitë kryesore të UET u riorganizuan në përputhje me Urdhrat e ministrit Nr. 526-528, datë 04.09.2018 dhe struktura organizative u plotësua me dy njësi të reja kryesore bazuar në Urdhrat e ministrit Nr. 529 dhe 530, datë 04.09.2018.
3. UET është akredituar për herë të parë si institucion i arsimit të lartë, me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009 dhe i është nënshtruar proceseve të akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.
4. UET është në pronësi të shoqërisë tregtare "UET" SHPK, e cila ka fituar personalitet juridik me vendimin Nr. 36117, datë 07.07.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

##### Neni 2

###### Qëllimi

Ky statut përcakton: organizimin, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

##### Neni 3

###### Ushtrimi i veprimtarisë

UET ushtron veprimtarinë e tij, në adresën: Ruga "Xhanfize Keko", Nd. 56, Kompleksi Xhura, Tiranë, Shqipëri, si dhe në adresat ku mund të zhvendoset në të ardhmen, të deklaruara zyrtarisht pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila verifikon dhe certifikon kapacitetet infrastrukturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

##### Neni 4

###### Veprimtaria

1. UET është një institucion jo publik i arsimit të lartë që kryen veprimtari mësimore e kërkimore, ai ndërthur, në mënyrë të integruar dhe në përputhje me planet mësimore, mësimdhënien me kërkimin shkencor, të organizuar ose të pavarur.
2. UET e kryen këtë veprimtari në përputhje dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



3. UET, në kuadër të veprimtarive të Shoqërisë "UET" SHPK, kryen edhe aktivitet të pavarur ekonomik, që rregullohet nga legjislati në fuqi.
4. Veprimtaria akademike e UET ushtrohet në zbatim të legjislati në fuqi dhe të këtij Statuti, në pavarësi relative me statutin e Shoqërisë "UET" SHPK.
5. UET, me qëllimin zhvillimin e kontributit në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor mund të krijojë dhe organizata jofitimprurëse.

#### Neni 5

##### Vizioni, Misioni dhe Vlerat

1. **Vizioni** i UET është të jetë lider i arsimit të lartë në Shqipëri, me ndikim të dukshëm në fushën e edukimit, shkencës, inovacionit dhe ndryshimeve të sotme shoqërore, i aftë për t'u përsosur vazhdimisht dhe përshtatur me dinamikën e ndryshimeve të shpejta të zhvillimit ekonomik dhe social të shoqërisë shqiptare dhe përtej saj, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me partnerë lokalë dhe ndërkombëtare për zhvillimin e dijes, shkencës dhe teknologjisë, për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të së mirës së përbashkët.
2. **Misioni** i UET, që prej themelimit të tij, është të ofrojë një pol alternativ në sektorin e arsimit të lartë shqiptar, edukim cilësor të mbështetur në praktikat më të mira, bashkëkohore të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit, me qëllim aftësimin e studentëve të tij me të gjitha kompetencat e nevojshme që kërkon dinamika e tregut të punës, të cilët do të jenë profesionistë dhe drejtues të së ardhmes, me impakt në zhvillimet ekonomike dhe shoqërore. UET udhëhiqet nga standardet europiane të cilësisë, nxit integrimin e dijes teorike me zbatimin praktik të saj, kërkimin shkencor aplikativ, ndërkombëtarizimin, dhe përfshirjen aktive të studentëve në procesin e mësimdhënies (student-centred learning), vendimmarrjes dhe projektet kërkimore.
3. **Vlerat:** Inkurajimi i kuriozitetit shkencor, respekti ndaj dinjitetit të njeriut dhe diversitetit kulturor, mendimi kritik, inovacioni, si dhe përfshirja e studentëve në procesin e qeverisjes së universitetit.
4. Objektivat strategjike të UET për realizimin e vizionit dhe misionit të tij, përcaktohen në Planin Strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili si rregull hartohet me kohëzgjatje 5 vjeçare, dhe miratohet nga Senati Akademik.

#### Neni 6

##### Parimet bazë


1. UET është institucion jopublik i arsimit të lartë, laik dhe me karakter jopolitik.
2. UET gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe për përzgjedhjen e personelit në përputhje me Kartën e Bolonjës dhe Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
3. UET udhëhiqet në ushtrimin e veprimtarisë së tij edhe nga parimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike, ligjshmërisë, drejtësisë dhe paanësisë, lirisë së mendimit dhe të shprehjes, meritokracisë dhe transparencës, mosdiskriminimit dhe barazisë, të informimit dhe të mbrojtjes të dhënave personale dhe të konfidencialitetit.

#### Neni 7

##### Të drejtat e UET

Në zbatim të autonomisë universitare dhe lirisë akademike UET ka të drejtë:

1. Të zgjedhë lirisht programet e studimit që do të ofrojë në institucion përkundërsisht plotësisht të standardeve akademike respektive; të miratojë plane, programe mësimore dhe të kërkimit shkencor, tekste në përdorim të studentëve të tij, si dhe literaturën përkatëse; të përcaktojë, nëse e vlerëson të arsyeshme, kriteret të veçanta për çdo program studimi, si kusht për pranimin e





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- studentëve në to, për çdo vit akademik; të përcaktojë procedurat dhe kriteret për dhënien e bursave të studimit.
2. Të zgjedhë lirisht strukturën organizative të UET, autoritetet dhe organet e veta drejtuese sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij Statuti; të përzgjedhë në mënyrë të pavarur personelin akademik, personelin ndihmës akademik dhe personelin administrativ; të caktojë numrin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tyre në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, këtij Statuti dhe akteve rregullatore.
  3. Të përcaktojë fushat e kërkimit shkencor dhe të zhvillojë programin e tij me orientim të gjerë evropian dhe ndërkombëtar;
  4. Të krijojë lidhje bashkëpunimi me struktura të institucionit të arsimit të lartë (të ngjashme ose të përafërta) ose të kërkimit shkencor brenda ose jashtë vendit që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë; të anëtarësohet në shoqata e organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë publik ose jo publik;
  5. Të ofrojë shërbime në fushat që kanë lidhje me zbatimin praktik të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë Statut;
  6. Të pranojë donacione nga fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë zhvillimin e Arsimit të Lartë;
  7. Të përdorë pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe asetet e tjera që ka në pronësi ose në posedim për qëllime të arsimit, ose që lidhen me të;
  8. Të zotërojë çdo lloj pasurie tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 8

##### Paprekshmëria/Imuniteti

1. Të gjitha mjediset e UET gëzojnë paprekshmërinë që Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", u garanton institucioneve të arsimit të lartë.
2. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike të UET bëhet vetëm në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në rastet e nevojës ekstreme dhe me kërkesën dhe/ose lejen e Rektorit ose të personave të autorizuar nga ai.
3. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e Rektorit.

#### Neni 9

##### Detyrimet e UET

1. Të zhvillojë procesin mësimor si dhe atë kërkimor e shkencor sipas standardeve ESG dhe atyre të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe në përputhje me normat dhe praktikatat bashkëkohore të vendeve që bëjnë pjesë në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD);
2. Të respektojë angazhimet e ndërmarra prej tij që burojnë nga kontratat me studentët dhe personelin;
3. Të raportojë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin për veprimtarinë e tij mësimore-shkencore sipas parashikimeve ligjore;
4. T'u nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit dhe atij institucional;
5. Të bëjë publike programet e studimit që ofron sipas niveleve;
6. Të bëjë të njohur publikisht raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, si dhe nëse programet e studimit që ai ofron janë të akredituara në respektim të afateve kohore të përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë;





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



7. Të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin çdo fillim viti akademik gjendjen financiare të institucionit, përbërjen e stafit akademik, si dhe tarifën e shkollimit për vitin në vazhdim, për secilin program studimi, konform legjislacionit në fuqi.

#### Neni 10

##### Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë

1. UET harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të UET. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:
  - a) Strukturave hierarkike organizative (organet dhe autoritetet drejtuese) të UET, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.
  - b) Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, e cila vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.
2. Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UET i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 11

##### Përfaqësimi juridik

1. UET përfaqësohet sipas rastit nga Rektori dhe/ose Administratori i UET.
2. Rektori është përgjegjës dhe përfaqëson UET për çështjet akademike dhe protokollare.
3. Administratori i UET është përgjegjës dhe përfaqëson UET për veprimtarinë ekonomike, administrative dhe financiare të institucionit.

#### KREU II

##### STRUKTURA ORGANIZATIVE E UET

#### Neni 12


##### Njësitë përbërëse

1. UET përbëhet nga njësi: kryesore, bazë, ndihmëse–akademike dhe njësi administrative.
2. Njësitë kryesore, bazë dhe ato ndihmëse–akademike krijohen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit.
3. Në UET, në të ardhmen, mund të krijohen edhe njësi të tjera kryesore, bazë ose ndihmëse–akademike, të cilat do të organizohen sipas parimeve të strukturës përkatëse, të shprehura në këtë statut, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

#### Neni 13

##### Njësitë kryesore

1. Njësi kryesore janë fakultetet si dhe institutet kërkimore -shkencore.
2. **Fakulteti** është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë. Fakulteti miraton paraprakisht kriteret e pranimit të





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësive bazë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015.
3. UET përbëhet nga jo më pak se 3 njësi kryesore. Shih Aneksin Nr. 1.

#### Neni 14

##### Njësitë bazë

1. Njësi bazë janë departamentet dhe qendrat kërkimore - shkencore.
2. **Departamenti** është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.
  - a) Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore- shkencore.
  - b) Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.
  - c) Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, këtë statut dhe rregulloret e UET.
3. **Qendra kërkimore - shkencore** është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.
  - a) Ajo ka në përbërje të saj të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.
  - b) Mënyra e organizimit dhe funksionimit të qendrave kërkimore - shkencore si dhe detyra të tjera të tyre përcaktohen në rregulloren përkatëse, pjesë e akteve rregullatore të UET.
  - c) Qendra mund të mbështetë realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" dhe "Doktoratë", të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës ose departamente të fakulteteve të tjera.
  - d) Struktura e qendrës, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i saj përcaktohen në statutin dhe në aktet e tjera të UET.
  - e) Kur qendra nuk përmbush standardet e njësisë bazë, ajo nuk llogaritet për qëllimin e përmbushjes së standardeve institucionale, si njësi bazë e njësisë kryesore.

#### Neni 15

##### Njësia e Standardeve dhe e Sigurimit të Cilësisë (NJSSC)

1. Njësia e Standardeve dhe e Sigurimit të Cilësisë, është një njësi e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ajo vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë, Kodin e Cilësisë, dhe legjislacionin në fuqi.
2. Njësia ngrihet në nivel institucioni dhe përbëhet nga drejtuesi i njësisë, dhe së paku dy anëtarë, përfaqësues nga personeli akademik dhe/ose ndihmës-akademik dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.
3. Anëtarët e njësisë propozohen nga Rektori, në konsultim me Dekanët e Fakulteteve, dhe miratohen nga Senati Akademik. Përfaqësuesi i studentëve zgjidhet në konsultë me Këshillin e Studentëve dhe i njoftohet Rektorit. Përfaqësuesi i studentëve duhet të ketë notë mesatare mbi 8.5.
4. Në përzgjedhjen e anëtarëve të NJSSC merren parasysh kriteret e mëposhtme:
  - a) Kompetencat profesionale;
  - b) Cilësitë personale (si ndershmëria, korrektesa, serioziteti, përgjegjshmëria, etj.);
  - c) Ngarkesa mësimore apo ngarkesa me kryerjen e funksioneve të tjera administrative;
  - d) Eksperienca e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt;





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- e) Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it.
5. Organizimi i veprimtarive monitoruese dhe vlerësuese të NJSSC përcaktohen në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe manualin për sigurimin e brendshëm të cilësisë.
  6. Funkcionet kryesore të NJSSC janë:
    - a. Zhvillon dhe zbaton strategjinë e universitetit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në funksion të forcimit të standardeve të cilësisë së aktiviteteve të mësimdhënies, kërkimit dhe proceseve administrative.
    - b. Zhvillon dhe përditëson politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me ndryshimet e standardeve të akreditimit dhe nevojave të institucionit.
    - c. Planifikon dhe zbaton proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, në nivel institucional dhe të programeve të studimit.
    - d. Monitoron dhe raporton në lidhje me performancën e institucionit, duke vënë në pah pikat e forta dhe aspektet që kanë nevojë për përmirësim.
    - e. Mbledh dhe analizon të dhëna mbi rezultatet akademike, nivelin e kënaqësisë së studentëve, dhe performancën e institucionit përmes pyetësorëve, focus grupeve, vlerësimeve me grupe ekspertësh, për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm.
    - f. Harton raporte periodike mbi veprimtarinë e njësisë dhe rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit.
    - g. Identifikon problematikat dhe rekomandon masa për të bërë korrektimet e nevojshme, për të siguruar ekselencën akademike dhe operacionale të institucionit.
    - h. Konsulton njësitë akademike dhe administrative për të vepruar në përputhje me kriteret dhe standardet e akreditimit.
    - i. Organizon takime informuese dhe trajnuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë e personelit dhe studentëve lidhur me proceset e sigurimit të cilësisë, duke promovuar krijimin e kulturës së cilësisë dhe ekselencës në të gjitha nivelet e universitetit.
  7. Mbështetur në legjislacionin për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave, NJSSC ka të drejtën e aksesit në të gjitha të dhënat e institucionit që lidhen me fushën e veprimtarisë së saj.
  8. Rezultatet e monitorimeve të NJSSC-së publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesve të Departamenteve.
  9. Raportet e vlerësimeve të kryera nga NJSSC për sigurimin e brendshëm të cilësisë përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

#### Neni 16

##### Njësitë ndihmëse mësimore

Njësi ndihmëse konsiderohen laboratorët, njësitë didaktike, bibliotekat, Njësia e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Projekteve dhe Ndërkombëtarizimit, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Marketingut, Zyra e Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe Statistikave, dhe njësi të tjera që mund të krijohen në të ardhmen për të realizuar studime dhe shërbime në kuadër të zhvillimit të procesit akademik dhe të kërkimit shkencor.

#### Neni 17

##### Njësitë administrative

Njësitë administrative krijohen me vendim të Bordit të Administrimit, bazuar në propozimet e Administratorit, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe mirëfunksionimit të institucionit. Në përputhje me këtë statut, organizimi dhe emërtimi i njësive administrative përcaktohet në Rregulloren e institucionit dhe akte të tjera rregullatore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar strukturën dhe funksionimin e njësive administrative përkatëse.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



### Neni 18

#### Organe dhe autoritete këshilluese

1. Organet këshilluese të UET janë:
  - a. Bordi i Besimit
  - b. Bordet e Tregut të Punës
  - c. Këshilli i Alumni-t.
2. **Bordi i Besimit** është një organ konsultativ i përbërë nga jo më pak se 5 personalitete të fushave të ndryshme. Përbërja dhe numri i anëtarëve të Bordit përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të "UET" Sh.p.k. Funkcionet kryesore të Bordit të Besimit janë:
  - a) emëron Presidentin e UET, me propozim të Asamblesë së Ortakëve, i cili është njëkohësisht edhe kryetar i Bordit të Besimit;
  - b) propozon kandidaturat për Rektor të institucionit.
  - c) konsulton mbi zgjedhjet dhe politikat e UET;
  - d) konsulton mbi projektet e zhvillimit;
  - e) lobon për imazhin e UET dhe lidhjet e UET me tregun e punës;
  - f) lobon për sa i përket politikave të Arsimit të Lartë në Shqipëri;
3. **Presidenti** ka mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Presidenti i përket kategorisë "Profesorë" të personelit akademik me kohë të plotë. Presidenti ushtron këto kompetenca:
  - a) koordinon aktivitetin e Bordit të Besimit;
  - b) ndjek zbatimin e vendimeve të Bordit dhe raporton para tij për realizimin e tyre;
  - c) drejton lobimin në funksion të përmbushjes së misionit të UET;
  - d) drejton promovimin dhe marrëdhëniet me publikun, përfshirë marrëdhëniet me median, pushtetin qendror dhe atë lokal; me përfaqësitë diplomatike si dhe organizatat ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj;
  - e) drejton dhe koordinon hartimin dhe zbatimin e planit strategjik të zhvillimit të UET;
  - f) drejton dhe koordinon veprimtaritë në kuadër të partneriteteve strategjike të UET;
4. **Bordet e Tregut të Punës** ngrihen në nivel Departamenti dhe përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë, të cilët janë drejtues, administratorë, menaxherë të sipërmarrjeve private ose institucioneve publike, me karrierë të spikatur profesionale, ish-studentë të UET.
  - a) Përpara fillimit të çdo viti akademik, Bordet konsultojnë programet e studimit dhe planet mësimore, për të garantuar përputhjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.
  - b) Në fund të çdo viti akademik, Bordet angazhohen për të garantuar mbarëvajtjen e praktikave profesionale, stazheve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me daljen e studentëve në tregun e punës.
5. **Këshilli i Alumni-t** përbëhet nga përfaqësues të UET Alumni me kontribut të spikatur në mbështetjen dhe zhvillimin e UET. Ky Këshill mbështet strategjinë e zhvillimit të UET dhe lobon në interes të arritjes së objektivave të vendosura.

### KREU III ORGANIZIMI AKADEMIK

#### Neni 19

##### Organet drejtuese akademike

1. Organet drejtuese të UET janë:
  - a. Senati Akademik





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin




- b. Rektorati
- c. Asambleja e Personelit Akademik
- d. Dekanati
- e. Këshilli i Etikës
- f. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", në nivel fakulteti
- g. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në nivel universiteti.

## Neni 20

### Senati Akademik

1. Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë akademik i UET dhe kryesohet dhe thirret nga Rektori. Në raste të veçanta dhe të jashtëzakonshme, Senati mund të thirret dhe nga 1/3 e anëtarëve të tij.
2. Senati Akademik mbledhet periodikisht, së paku 2 herë në vit.
3. Senati Akademik përbëhet nga jo më pak se 19 anëtarë, nga të cilët jo më pak se 3 përfaqësues anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë për njësi kryesore, si edhe 3 përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Njësitë kryesore me numër të lartë studentësh mund të përfaqësohen me më shumë se 3 përfaqësues.
4. Senati akademik kryesohet nga Rektori. Anëtarët e Senatit Akademik, zgjidhen nga asambletë e personelit akademik të fakulteteve, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar, që plotësojnë kriteret e ligjit. Anëtarë të senatit akademik janë edhe kryetari i Këshillit Studentor dhe dy studentë të tjerë përfaqësues të tre cikleve të studimit, që zgjidhen nga këshilli studentor, mandati i të cilëve është 2- vjeçar.
5. Senati i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet kuorumi i nevojshëm prej 2/3 të anëtarëve dhe merr vendim për çështje brenda kompetencave të tij me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës. Në rast mungese, Rektori mund të autorizojë zëvendësrektorin për të drejtuar mbledhjen.
6. Mandati i anëtarëve të senatit mbaron:
  - a) me mbarimin e afatit 4 vjeçar;
  - b) me kërkesën e tyre;
  - c) kur mungon në më shumë se 2 (dy) mbledhje të Senatit;
  - d) për shkelje të kodit etik të Institucionit;
  - e) në rastet kur ndaj tyre ka filluar dhe mbetet në fuqi një procedim penal;
  - f) në rastet e përfundimit të marrëdhënieve të punës me UET, ose me përfundimin e studimeve në rastin e anëtarëve përfaqësues të studentëve;
  - g) kur humbet zotësinë juridike për të vepruar;
  - h) në rast ushtrimit të së drejtës së vitit sabatik;
  - i) në rast vendimmarrje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për riorganizim të Senatit;
7. Plotësimi i vendit vankant, në rast të përfundimit të mandatit para kohe të një prej anëtarëve, sipas pikës 6, gërmat a deri në h, bëhet përmes emërimit të anëtarit të radhës në listën e kandidatëve, sipas rezultatit të zgjedhjeve. Nëse kandidatë të tillë nuk ka, Rektori komandon një nga anëtarët e personelit akademik që plotëson kriteret, deri në mbajtjen e zgjedhjeve të radhës.
8. Funkcionet kryesore të Senatit Akademik në drejtimin akademik-shkencor janë:
  - a) garanton autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
  - b) miraton statutin e UET me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;



- c) miraton paraprakisht planin strategjik të institucionit dhe ia propozon për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit;
- d) miraton, pasi merr mendimin e Bordit të Administrimit, rregulloren e UET
- e) miraton Kodin e Etikës dhe rregulloret e tjera me karakter akademik, mbështetur në propozimet e Rektoratit;
- f) vlerëson dhe miraton paraprakisht programet e studimit, programet e kërkimit dhe të zhvillimit në kuadër të hapjes, ndryshimit dhe mbylljes së tyre, me propozim të Rektoratit dhe/ose njësisë kryesore të UET. Senati Akademik e ushtron këtë kompetencë në përputhje me planin disaveçar të zhvillimit të UET dhe duke marrë në konsideratë interesat financiarë të UET;
- g) propozon riorganizimin dhe mbylljen e universitetit, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me institucione të tjera të arsimit të lartë;
- h) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësisë të universitetit, mbi bazën e propozimeve të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë, pas vlerësimit paraprak nga Bordi i Administrimit;
- i) harton strukturën e përgjithshme të universitetit dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet.
- j) i propozon ministrisë përgjegjëse për arsimin hapjen, mbylljen ndryshimin dhe emërtimin e njësisë kryesore dhe të programeve të studimit.
- k) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore dhe mbikëqyr zbatimin e tij ;
- l) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- m) jep mendimin e tij në lidhje me projekt-buxhetin e UET, përpara miratimit të tij nga Bordi i Administrimit;
- n) garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në UET;
- o) krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
- p) ngre komisione të përhershme për të ndjekur drejtimit më të rëndësishme të veprimtarisë së institucionit dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre.
- q) miraton anëtarësimin e universitetit në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare me veprimtari në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, lidhjet e binjakëzimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, si dhe me organizata të tjera jofitimprurëse, donatorë vendas e të huaj, që mund të ndihmojnë në zhvillimin e institucionit.
- r) organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare;
- s) përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës dhe të njësisë për Standardet dhe Sigurimin e Cilësisë;
- t) miraton kuotat dhe kriteret e pranimit mbështetur në propozimet e njësisë bazë, në përputhje me kapacitetet pritëse të institucionit, pas miratimit paraprak nga Bordi i Administrimit;
- u) jep titullin "*Doctor Honoris Causa*" personaliteteve të ndryshëm, vendas apo të huaj, që kanë dhënë një kontribut në fushën e shkencës, artit, kulturës, politikës dhe ekonomisë.
- v) jep "Certifikatë Mirënjohjeje" për personalitete me kontribut të caktuar në fushën e shkencës, artit, kulturës, politikës, ekonomisë, sportit, etj.

#### Neni 21

#### Rektorati

1. Rektorati është një organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:
  - a. Rektori
  - b. Zëvendësrektorit/ët





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- c. Administratori i UET
  - d. Drejtuesit e njësive kryesore
  - e. Prorektori
  - f. Sekretari i Përgjithshëm
  - g. Drejtuesi i Njesisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë.
2. Rektorati, përveç misionit, të drejtave dhe detyrave të përcaktuara nga ligji, ka edhe këto kompetenca e funksione:
- a. harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të institucionit, si dhe ato të administratorëve të tyre;
  - b. harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik;
  - c. ushtron kontrolle, me iniciativën e vet ose me kërkesë të organeve drejtuese të universitetit, lidhur me cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit, akteve të brendshme të Universitetit, zbatimin e kontratave të punës dhe për çdo veprimtari tjetër me interes për mbarëvajtjen e institucionit.
  - d. monitoron procesin e kualifikimit akademik të personelit akademik dhe rekomandon masat dhe krijon mekanizma për të nxitur e mbështetur këtë proces;
  - e. paraqet rekomandime për programet e studimeve, dhe projektet e kërkimit shkencor dhe zhvillimit, si dhe ndryshimet e tyre;
  - f. zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik të cilat i ngarkohen këtij organi;
  - g. monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit;
  - h. paraqet në Senatin Akademik propozimet për strukturën e përgjithshme të institucionit, si dhe numrin e personelit sipas kategorive për të gjitha nivelet;
  - i. harton raportin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore dhe e paraqet atë për miratim në Senatin Akademik;
  - j. trajton dhe vendos për ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve;
  - k. trajton dhe zgjidh mosmarrëveshjet mes drejtuesve të njësive kryesore, apo njësive të tjera të institucionit.
  - l. ushtron kompetenca të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, këtë Statut dhe akte të tjera rregullatorë të institucionit.
3. Rektorati si organ kolegjal funksionon me mbledhje. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë, në mbledhje të organizuara rregullisht me tematikë të përcaktuar e të njoftuar të paktën dy ditë para mbledhjes. Në raste urgjente, tematika komunikohet në fillim të mbledhjes.
4. Mbledhja e Rektoratit kryesohet dhe thirret nga Rektori, ose një e treta e anëtarëve të tij, dhe është e vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
5. Sipas tematikës, në mbledhje mund të ftohen të marrin pjesë edhe Drejtuesit e Departamenteve dhe drejtues të njësive të tjera administrative të UET.
6. Organizimi dhe veprimtaria e Rektoratit përcaktohet me rregullore të veçantë, e cila miratohet nga Senati Akademik.

## Neni 22

### Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.
2. Asambleja e personelit akademik të njësive kryesore ka këto funksione:
  - a. zgjedh anëtarët e Senatit Akademik;





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- b. zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore.

### Neni 23

#### Dekanati

1. Dekanati është organ kolegjal vendimmarrës, që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
  - a) Dekani
  - b) Zëvendësdekani (nëse ka)
  - c) Administratori i Fakultetit
  - d) Drejtuesit e Departamenteve
  - e) Drejtuesi i Qendrës së Kërkimore – shkencore (nëse ka)
  - f) Përgjegjësit e grupeve mësimore
  - g) Kryetari i Këshillit Studentor të Fakultetit si përfaqësues i studentëve.
2. Dekanati i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet kuorumi i nevojshëm prej 2/3 të anëtarëve. Ai merr vendim për çështje brenda kompetencave të tij me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës.
3. Dekanati kryen funksionet e mëposhtme:
  - a) harton planin strategjik të zhvillimit të Fakultetit, mbështetur në propozimet e njësisë bazë të tij, si dhe ato të administratorit të njësisë kryesore;
  - b) koordinon veprimtarinë e njësisë bazë;
  - c) programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit;
  - d) bën propozime në Senat për programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor, ose edhe për ndryshime në programet ekzistuese të studimit, mbështetur në propozimet e ardhura nga departamentet ose edhe me iniciativën e tij;
  - e) i propozon Senatit për dhënien e mendimit paraprak në lidhje me hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësisë të tjera;
  - f) përgatit rregulloren mësimore për çdo program studimi të njësisë së tij, dhe ia dërgon për miratim Senatit Akademik;
  - g) i propozon Senatit kriteret e veçanta për pranimin e studentëve në programet e studimit;
  - h) jep mendim për rregulloren e institucionit, për çështje brenda fushave të tij të kompetencës;
  - i) jep mendim për rregullore ose akte të tjera të institucionit, mbështetur në kërkesën e Rektorit;
  - j) shqyrton dhe miraton raportin vjetor të Dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor;
  - k) i propozon Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij;
  - l) shqyrton dhe miraton temat e diplomave të studentëve që ndjekin studimet në programet me karakter profesional dhe programet ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.
  - m) çdo funksion tjetër në përputhje me përcaktimet në rregulloren e institucionit dhe këtë statut.

### Neni 24

#### Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjal vendimmarrës, i cili ngrihet pranë UET si një strukturë e përhershme.
2. Ai promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale. Këshilli i Etikës shqyrton sjellje të ndryshme të personelit akademik dhe atij ndihmës të institucionit nëse përbëjnë shkelje të etikës ose jo. Këshilli shqyrton gjithashtu edhe sjellje të studentëve gjatë veprimtarisë së tyre mësimore e kërkuese në institucion, nëse ato përbëjnë shkelje të etikës së studentit. Këshilli i Etikës mbledhet





malora premunt / gjëra të mëdha na presin



- sa herë ka çështje për të diskutuar brenda juridiksionit të tij. Ai merr vendim me shumicë të thjeshtë (50%+1) dhe i bën propozime Rektorit për këto çështje.
3. Këshilli i Etikës përbëhet nga 7 anëtarë dhe kryesohet nga zëvendësrektori. Anëtarët përzgjidhen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit. Kandidatët e propozuar nga Rektori përfaqësojnë secilën prej njësive kryesore dhe një prej tyre përfaqëson studentët, i rekomanduar nga vetë Këshilli e Studentëve.
  4. Në lidhje me çështjet e etikës dhe të integritetit akademik në UET, çfarë nuk parashikohet në këtë Statut dhe në Rregulloren e UET, rregullohet nga Kodi i Etikës dhe Kodi i Integritetit Akademik të UET, të cilat janë akte të veçanta të cilat i bashkëlidhen rregullores së institucionit dhe miratohen nga Senati Akademik.

#### Neni 25

##### Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale, që kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.
2. Komisionet e përhershme krijohen në nivel universiteti dhe fakulteti. Ato përbëhen prej jo më pak se pesë anëtarësh.
3. Mënyra e zgjedhjes, procedura, funksionet dhe organizimi i këtyre komisioneve përcaktohen me rregullore të veçantë, në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë në Shqipëri.
4. Komisionet e përhershme në UET janë:
  - a. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në nivel universiteti. Anëtarët e këtij komisioni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ata mbajnë titullin "Profesor".
  - b. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", në nivel fakulteti. Anëtarët e këtij komisioni vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të fakultetit midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Ata mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar".

#### Neni 26

##### Autoritetet drejtuese akademike

1. Autoritete drejtuese akademike në UET janë:
  - a) Rektori
  - b) Drejtuesi i njësisë kryesore/Dekani
  - c) Drejtuesi i njësisë bazë/Drejtuesi i Departamentit ose Drejtuesi i Qendrës kërkimore - shkencore.
2. Autoritetet drejtuese të UET janë personel akademik i punësuar me kohë të plotë. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve drejtuese rregullohen me kontratë dhe/ose vendim të veçantë.
3. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit, shkarkimit, liritimit nga detyra apo dorëheqjes së autoritetit drejtues nga pozicioni drejtues, kontrata bazë e punës midis UET dhe individit, në cilësinë e tij si anëtar i personelit akademik nuk cenohet. Mandati i anëtarit të ri zëvendësues është plotësues deri në mbajtjen e zgjedhjeve të radhës.






maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



## Neni 27

### Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i UET, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori mban titullin "Profesor".
3. Rektori propozohet nga Bordi i Besimit, zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të "UET" SHPK, me shumicë të cilësuar, dhe emërohet nga Administratori i "UET" SHPK. Marrëdhëniet e tij me institucionin rregullohen nga Kodi i Punës, Ligji nr. 80/2015, ky Statut dhe sipas përcaktimeve të vendosura në kontratën e punës. Rektori ka mandat 4 vjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë. Procedura e riemërimit realizohet me shprehje të vullnetit të palëve, paraqitur jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit. Me mbarimin e mandatit, Rektori vazhdon të jetë anëtar i njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
4. Mandati i Rektorit mbaron:
  - a) me kalimin e afatit ligjor;
  - b) kur ai largohet për çështje personale duke dhënë dorëheqjen nga pozicioni;
  - c) në kushtet e pamundësisë fizike dhe mendore për të kryer detyrën;
  - d) kur zgjidhet kontrata e punës;
  - e) kur i përfundon kontrata e punës;
  - f) kur shkel Statutin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, dhe
  - g) në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmton rezultatin financiar dhe/ose imazhin e institucionit, ose në rastin e konfliktit të interesit.
  - h) Në rastet kur ndaj Rektorit hapet ndonjë çështje penale, ai mund të pezullohet nga detyra deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga organet përkatëse. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të "UET" SHPK komandon në detyrë një prej zëvendësrektorëve deri në rikthimin në detyrë të Rektorit ose emërimin e Rektorit të ri.
5. Ushtrimi i funksioneve realizohet në përmbushje të misionit, qëllimit dhe interesit të UET. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Rektorit:
  - a) drejton Senatit Akademik dhe raporton para tij;
  - b) nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik;
  - c) l paraqet senatit planin strategjik të zhvillimit të UET;
  - d) drejton procesin akademik dhe shkencor të UET;
  - e) ndjek dhe siguron zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, të vendimeve të Rektoratit dhe vendimet që burojnë nga zbatimi i akteve ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me disiplinimin e aktivitetit mësimor dhe shkencor të UET, si edhe nxjerr akte të nevojshme në zbatim të tyre;
  - f) miraton planet strategjike të zhvillimit të fakulteteve;
  - g) i paraqet Senatit Akademik projektbuxhetin e institucionit për të dhënë mendim para miratimit nga Bordi i Administrimit, si dhe planin afatmesëm të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
  - h) i paraqet Senatit Akademik statutin e institucionit si edhe ndryshimet që mund t'i bëhen atij si dhe rregulloren e institucionit dhe akte të tjera rregullatore që janë kompetencë e këtij të fundit;
  - i) monitoron dhe garanton lirinë akademike e kërkimore të personelit akademik të UET;
  - j) organizon ose ushtron kontrolle në fakultete e departamente për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kualifikimit të personelit akademik;
  - k) është përgjegjës për garantimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe performancës së personelit akademik;
  - l) i raporton Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "UET" shpk për ecurinë e procesit të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike, sa herë lind një nevojë e tillë.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- m) bashkërendon punën me Administratorin, për monitorimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve të personelit akademik dhe ndihmës akademik që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, në zbatim të Kodit të punës, Ligjit Nr. 80/2015, këtij Statuti dhe të Kontratës së punës.
  - n) monitoron implementimin e kërkimit shkencor, përfshirë grantet, donacionet dhe çdo fond tjetër në mbështetje të këtij kërkimi, në bashkëpunim dhe në koordinim me Administratorin;
  - o) ngre komisione e grupe pune me qëllim kontrolli, studimi apo veprimtari të veçanta;
  - p) organizon procesin e përzgjedhjes së kandidaturave të personelit akademik të UET, dhe emëron personelin akademik dhe ndihmës akademik të brendshëm dhe të jashtëm për secilin nga fakultetet e UET, në përputhje me rezultatet e konkursit;
  - q) emëron, komandon dhe shkarkon zëvendësrektorin dhe prorektorin, dekanët e fakulteteve, zëvendësdekanët e fakulteteve, drejtuesit e departamenteve dhe drejtuesit e Qendrave Kërkimore Shkencore, në përputhje me përcaktimet në këtë statut;
  - r) përcakton fushën e veprimit të zëvendësrektorëve sipas nevojave të institucionit, në përputhje me këtë statut dhe rregulloren e UET.
  - s) trajton ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të UET dhe u propozon strukturave përkatëse marrjen e vendimeve në lidhje me to.
  - t) shqyrton dhe vendos për miratimin e rasteve përjashtimore të procesit mësimor e akademik. Në çdo rast, vendimi nuk mund të anashkalojë detyrimin për shlyerjen e detyrimeve që garantojnë përmbushjen e standardeve akademike;
  - u) nënshkruan diplomat për të gjitha ciklet e studimit, pa të drejtë delegimi; si dhe certifikata të tjera të UET;
  - v) mbikëqyr jetën dhe aktivitetet studentore, si dhe procesin e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit;
  - w) nënshkruan marrëveshje të ndryshme me karakter akademik dhe kërkimor-shkencor me institucione të ndryshme shqiptare dhe të huaja. Në disa raste, sipas gjykimit të tij, ai mund ta delegojë të drejtën e firmës te Dekanët, për marrëveshje fusha e veprimit të të cilave lidhet specifikisht me fushat e studimit të Fakultetit përkatës.
  - x) paraqet propozime për aktet që janë kompetencë e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.
  - y) ushtron kompetenca të tjera në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe këtë Statut.
6. Në ushtrimin e kompetencave të tij, rektori shprehet sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime.

#### Neni 28

#### Dekani

1. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësive kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
2. Dekani është personel akademik i kategorisë "Profesorë".
3. Dekani përzgjidhet mbi bazën e një procedurë konkurrimi. Thirrja për aplikim i drejtohet kryesisht personelit të Fakultetit, por është e hapur edhe për anëtarë jashtë UET-it. Kandidatët për Dekan duhet të propozojnë një Projekt për zhvillimin e njësive kryesore, shoqëruar me një CV akademike dhe letër interesi.
4. Aplikimet vlerësohen nga një komision i posaçëm që ngrihet nga Rektori, dhe nëse shihet e arsyeshme, ka në përbërje edhe ekspertë të jashtëm. Përzgjedhja bazohet kryesisht në kriteret e mëposhtme:
  - a) Profili akademik dhe përvoja në mësimdhënie;
  - b) Produktiviteti kërkimor-shkencor;
  - c) Përvoja dhe aftësitë drejtuese, administrative;






maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- d) Cilësia e projektit të paraqitur, vizioni për zhvillimin dhe drejtimin e Fakultetit;
- e) Aftësitë komunikuese dhe të punës në grup;
5. Komisioni i posaçëm i paraqet Rektorit për miratim propozimin për kandidaturën fituese.
6. Dekani emërohet nga Rektori. Marrëdhëniet e tij të punës rregullohen në kontratën e punës dhe në aktet e tjera.
7. Dekani emërohet me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
8. Mandati i Dekanit mbaron:
  - a) me kalimin e afatit ligjor të kohëzgjatjes së mandatit,
  - b) kur ai largohet, për çështje personale duke dhënë dorëheqjen nga pozicioni,
  - c) në kushtet e pamundësisë fizike dhe mendore për të kryer detyrën,
  - d) kur zgjidhet kontrata e punës,
  - e) kur i përfundon kontrata e punës,
  - f) kur shkel Statutin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, dhe në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmton rezultatin financiar dhe/ose imazhin e institucionit, ose në rastin e konfliktit të interesit.
  - g) Në rastet kur ndaj Dekanit hapet ndonjë çështje penale, ai mund të pezullohet nga detyra deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga organet përkatëse. Në këtë rast, Rektori komandon një person tjetër, i cili përmbush kriteret për të ushtruar detyrën, sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij Statuti.
9. Në rast të mbarimit të mandatit para kohe, deri në organizimin e procesit të përzgjedhjes me konkurim, Rektori komandon një person tjetër, nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë ose kandidatë jashtë UET, i cili përmbush kriteret për të ushtruar detyrën.
10. Dekani i Fakultetit, ka këto kompetenca:
  - a) organizon, koordinon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe shkencor të Fakultetit;
  - b) për çdo vendimarrje të Dekanatit përgatit propozimin përkatës;
  - c) ushtron kontrole për cilësinë e zhvillimit të proceseve akademike me karakter mësimor e të kërkimit shkencor, zbatimit të kontratës së punës dhe detyrimeve të tjera të marra nga departamenti apo personeli akademik i fakultetit;
  - d) paraqet raportin vjetor ose raportimet me kërkesë të organeve të fakultetit apo edhe me iniciativë të tij përpara Dekanatit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në Fakultet;
  - e) paraqet në Dekanat me iniciativën e tij ose të njëjësive bazë të fakultetit propozimet për hapjen, mbylljen, reformimin e kurrikulave të departamenteve apo njëjësive të veçanta të tij;
  - f) ngre dhe miraton komisionet për përzgjedhjen e studentëve të rinj që pranohen çdo vit akademik;
  - g) është pjesë e komisionit për vlerësimin e kandidaturave të stafit akademik të UET për Fakultetin që drejton;
  - h) bën propozimin për punësimin si pjesë e stafit akademik të kandidaturës së përzgjedhur, e cila është kusht për lidhjen e Kontratës së Punës mes personelit akademik dhe UET;
  - i) bën vlerësimin e performancës së anëtarëve të personelit të njëjësive kryesore gjatë vitit akademik;
  - j) ngre komisionet *ad-hoc* sipas parashikimeve të përcaktuara në rregulloret e UET;
  - k) trajton rastet e shkeljeve të disiplinës, duke iu propozuar organeve kompetente masat përkatëse, sipas përcaktimeve në Statut, Kodin e Etikës dhe Rregulloren e UET ;
  - l) së bashku me Rektordin nënshkruan diplomat e studentëve;
  - m) propozon masa disiplinore në Këshillin e Etikës për studentët, anëtarët e personelit akademik dhe atij ndihmës që kanë kryer veprime në kundërshtim me statutin dhe Rregulloren e UET,



- kanë thyer Kodin e Etikës, apo nuk kanë respektuar detyrimet e përcaktuara në Kontratën e studentit, Kodin e Punës ose në kontratën e punës;
- n) i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.
11. Dekani mund të ushtrojë njëkohësisht edhe detyrën e zëvendësrektorit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 80/2015 dhe kompetencat e autorizuara nga Rektori”.

#### Neni 29

##### Drejtuesi i njësisë bazë/Departamentit

1. Drejtuesi i Departamentit është autoriteti drejtues akademik i Departamentit dhe e përfaqëson atë.
2. Drejtuesi i Departamentit është personel akademik i kategorisë “Profesorë” ose ka gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të përzgjidhet një kandidat që mban gradën shkencore “Doktor”.
3. Drejtuesi i Departamentit përzgjidhet me konkurrim. Thirrja për aplikim i drejtohet kryesisht personelit të Departamentit, por është e hapur edhe për anëtarë jashtë UET-it. Kandidatët për Drejtues Departamenti duhet të propozojnë një Projekt për zhvillimin e departamentit, shoqëruar me një CV akademike dhe letër interesi.
4. Aplikimet vlerësohen nga një komision i posaçëm që ngrihet nga Rektori, dhe kryesohet nga Dekani i fakultetit përkatës. Komisioni mund të ketë në përbërje edhe ekspertë të jashtëm. Përzgjedhja bazohet kryesisht në kriteret e mëposhtme:
  - a) Profili akademik dhe përvoja në mësimdhënie;
  - b) Produktiviteti kërkimor-shkencor;
  - c) Përvoja dhe aftësitë drejtuese, administrative;
  - d) Cilësia e projektit të paraqitur, vizioni për zhvillimin dhe drejtimin e Departamentit;
  - e) Aftësitë komunikuese dhe të punës në grup;
5. Komisioni i posaçëm i propozon Rektorit kandidatin fitues për Drejtues Departamenti.
6. Drejtuesi i Departamentit emërohet nga Rektori. Marrëdhëniet e tij me të punës rregullohen në kontratën e punës dhe në aktet e tjera.
7. Drejtuesi i Departamentit emërohet me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
8. Mandati i Drejtuesit të Departamentit mbaron:
  - a) me kalimin e afatit ligjor,
  - b) kur ai largohet, për çështje personale duke dhënë dorëheqjen nga pozicioni,
  - c) në kushtet e pamundësisë fizike dhe mendore për të kryer detyrën,
  - d) kur zgjidhet kontrata e punës,
  - e) kur i përfundon kontrata e punës,
  - f) kur shkel Statutin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, dhe në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmton rezultatin financiar dhe/ose imazhin e institucionit, ose në rastin e konfliktit të interesit.
  - g) Në rastet kur ndaj tij hapet ndonjë çështje penale, ai mund të pezullohet nga detyra deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga organet përkatëse. Në këtë rast, Rektori komandon një anëtar tjetër të personelit akademik, i cili përmbush kriteret për kryerjen e detyrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parashikimet e këtij Statuti.
9. Në rast të mbarimit të mandatit para kohe, deri në organizimin e procesit të përzgjedhjes me konkurrim, Rektori komandon një person tjetër, nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë ose kandidatë jashtë UET, i cili përmbush kriteret për të ushtruar detyrën.
10. Drejtuesi i Departamentit ka këto kompetenca:
  - a) organizon, koordinon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe kërkimor shkencor të Departamentit;
  - b) shqyrton planet mësimore dhe programet mësimore dhe propozon ndryshimet e nevojshme;



**Universiteti  
Europian i  
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- c) shqyrton dhe miraton propozimet e përgjegjës të grupit mësimor për tekstet mësimore që do të përdoren;
- d) ndjek realizimin e programit mësimor sipas planit të miratuar dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies;
- e) merr pjesë në komisionet e përzgjedhjes së pedagogëve të rinj për departamentin që drejton;
- f) bën vlerësimin e pedagogëve të departamentit gjatë vitit akademik, përmes mjeteve si: vëzhgimit në auditor gjatë zhvillimit të seancës mësimore, procesit të *folloë-up* për vlerësimin e performancës.
- g) çdo kompetencë tjetër në përputhje me përcaktimet në këtë statut dhe aktet rregullatore.

### Neni 30

#### Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore

1. Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore është autoriteti drejtues akademik i Qendrës Kërkimore Shkencore dhe e përfaqëson atë. Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore është personel akademik i kategorisë "Profesor" ose ka gradën shkencore "Doktor" (PhD), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të përzgjidhet një kandidat që mban gradën shkencore "Doktor".
2. Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore përzgjidhet me konkurrim. Thirrja për aplikim i drejtohet kryesisht personelit të njësisë kryesore të angazhuar me kohë të plotë, por është e hapur edhe për anëtarë jashtë UET-it. Kandidatët për Drejtues të Qendrës Kërkimore Shkencore duhet të propozojnë një Projekt për zhvillimin e qendrës, shoqëruar me një CV akademike dhe letër interesi.
3. Aplikimet vlerësohen nga një komision i posaçëm që ngrihet nga Rektori, dhe kryesohet nga Dekani i fakultetit përkatës. Komisioni mund të ketë në përbërje edhe ekspertë të jashtëm. Përzgjedhja bazohet kryesisht në kriteret e mëposhtme:
  - a) Profili akademik dhe përvoja në drejtim dhe menaxhim projektsh;
  - b) Produktiviteti kërkimor-shkencor;
  - c) Përvoja dhe aftësitë drejtuese, administrative;
  - d) Cilësia e projektit të paraqitur, vizioni për zhvillimin dhe drejtimin e qendrës;
  - e) Aftësitë komunikuese dhe të punës në grup.
4. Komisioni i posaçëm i propozon Rektorit kandidatin fitues për Drejtues të Qendrës Kërkimore Shkencore.
5. Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore emërohet nga Rektori. Marrëdhëniet e tij të punës rregullohen në kontratën e punës.
6. Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore emërohet me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
7. Mandati i Drejtuesit të Qendrës Kërkimore Shkencore mbaron:
  - a) me kalimin e afatit ligjor,
  - b) kur ai largohet, për çështje personale duke dhënë dorëheqjen nga pozicioni,
  - c) në kushtet e pamundësisë fizike dhe mendore për të kryer detyrën,
  - d) kur zgjidhet kontrata e punës,
  - e) kur i përfundon kontrata e punës, kur shkel Statutin dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, dhe në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmton rezultatin financiar dhe/ose imazhin e institucionit, ose në rastin e konfliktit të interesit.
  - f) Në rastet kur ndaj tij hapet ndonjë çështje penale, ai mund të pezullohet nga detyra deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga organet përkatëse. Në këtë rast, Rektori komandon komandon një anëtar tjetër të personelit akademik, i cili përmbush kriteret për kryerjen e detyrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parashikimet e këtij Statuti.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



8. Në rast të mbarimit të mandatit para kohe, deri në organizimin e procesit të përzgjedhjes me konkurim, Rektori komandon një person tjetër, nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë ose kandidatë jashtë UET, i cili përmbush kriteret për të ushtruar detyrën.
9. Drejtuesi Qendres Kërkimore Shkencore ka këto kompetenca:
  - a) përcakton programin dhe tematikën e punës shkencore në Qendër;
  - b) udhëheq dhe kontrollon realizimin e programit në lidhje me studimet dhe trajnimet sipas tematikës përkatëse;
  - c) bën vlerësimin e punës shkencore të anëtarëve të Qendrës gjatë vitit akademik;
  - d) bashkëpunon ngushtë me departamentet e tjera të Fakultetit përkatës dhe strukturat e tjera të UET.
  - e) çdo kompetencë tjetër në përputhje me përcaktimet në këtë statut dhe aktet rregullatore.

#### Neni 31

##### Autoritete drejtuese të tjera


Autoritete të tjera të UET janë:

- a) Zëvendësrektori
- b) Prorektori
- c) Sekretari i Përgjithshëm
- d) Zëvendësdekani
- e) Përgjegjësi i grupit mësimor.

#### Neni 32


##### Zëvendësrektori

1. Rektori emëron dhe shkarkon Zëvendësrektorin, mbi propozimin drejtuar Senatit Akademik, dhe pas miratimit të këtij të fundit. Paraprakisht, propozimi duhet të marrë gjithashtu pëlqimin e Bordit të Administrimit. Zëvendësrektori ka mandat 4 vjeçar, me të drejtë riemërimi.
2. Zëvendësrektori mbështet Rektorin në menaxhimin e aktiviteteve akademike dhe administrative. Detyrat e tij variojnë në përputhje me përgjegjësitë që i caktohen nga Rektori, nga ky Statut dhe aktet e tjera të brendshme të Universitetit.
3. Në mungesë të Rektorit ose për arsye të tjera që e bëjnë të pamundur ushtrimin e detyrave të tij, Zëvendësrektori zëvendëson Rektorin në ushtrimin e tyre, me përjashtim të rastit kur në këtë Statut përcaktohet ndryshe.
4. Zëvendësrektori është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, i kategorisë "Profesorë" ose ka gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ai duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
  - a) Të ketë përvojë në mësimdhënie dhe/ose kërkim shkencor jo më pak se 8 (tetë) vjet.
  - b) Të ketë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të lëndëve, hartues kurrikulash dhe programesh lënde dhe/ose zhvilluar projekte kërkimore, etj. prej të paktën 3 (tre) vitesh.
  - c) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
  - d) Të mos jetë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale.
5. Rektori i propozon Senatit Akademik shkarkimin e zëvendësrektorit nga kjo detyrë në rast të moskryerjes së detyrave të ngarkuara ose në rast të shkeljeve të rënda në kryerjen e detyrave të ngarkuara.
6. UET ka në strukturën e tij organizative 1 (një) zëvendësrektor.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



### Neni 33

#### Prorektori

1. Prorektori emërohet dhe shkarkohet nga Rektori, mbi propozimin drejtuar Senatit Akadamik, dhe pas miratimit të këtij të fundit. Paraprakisht, propozimi duhet të marrë gjithashtu pëlqimin e Bordit të Administrimit. Prorektori ka mandat 4 vjeçar, me të drejtë riemërimi.
2. Prorektori duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
  - a) Të ketë përvojë akademike dhe/ose administrative në drejtimin dhe menaxhimin e proceseve akademike dhe/ose të sigurimit të brendshëm ose të jashtëm të cilësisë, prej së paku 5 vitesh;
  - b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
  - c) Të mos jetë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale.
3. Prorektori është autoriteti përgjegjës për mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të zhvillimit të proceseve akademike dhe sigurimit të cilësisë.
4. Prorektori ka këto kompetenca kryesore:
  - a) përgjigjet për mbarëvajtjen dhe sigurimin e cilësisë së procesit akademik;
  - b) koordinon veprimtaritë akademike përmes bashkëpunimit me dekanët dhe drejtuesit e departamenteve;
  - c) bashkërendon punën me njësinë e standardeve dhe sigurimit e brendshëm të cilësisë dhe zyrën e kurrikulave.
  - d) kryen detyrat që i ngarkohen nga Rektori dhe i raporton atij për realizimin e tyre.

### Neni 34

#### Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Administratori me propozim të Rektorit.
2. Sekretari i Përgjithshëm ka këto kompetenca:
  - a) drejton dhe koordinon punën e Sekretarisë Mësimore dhe të koordinatorëve të fakulteteve për zhvillimin e veprimtarive mësimore;
  - b) në koordinim me dekanatin përgatit kalendarin akademik të mësimdhënies në UET dhe garanton zbatimin e tij në bashkëpunim me fakultetet përkatëse;
  - c) monitoron cilësinë dhe saktësinë e dokumentacionit për të dhënat nga zhvillimi i procesit mësimor, studentët, të dhënat statistikore që mblidhen, përpunohen, raportohen pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin ose përdoren për lëshimin e diplomave, certifikatave dhe dokumenteve të tjerë të lidhur me mësimdhënien në UET;
  - d) ndjek përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të personelit akademik të UET për sa i përket ngarkesës së tyre mësimore dhe informon Zyrën e Burimeve Njerëzore;
  - e) koordinon procesin e transferimit, të mobilitetit, të ndërprerjes dhe të rifillimit të studimeve në UET sipas parashikimeve të Rregullores së UET;
  - f) zbaton çdo detyrë tjetër që mund t'i ngarkohet nga Rektori dhe/ose Administratori dhe raporton përkatësisht për realizimin e saj.

### Neni 35

#### Zëvendësdekani

1. Zëvendësdekani ndihmon Dekanin në drejtimin e fakultetit dhe përgjigjet përpara tij dhe Rektoratit për detyrat e ngarkuara. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Dekani i Fakultetit përkatës, pas konsultimit me Rektorin.
2. Zëvendësdekani është anëtar i personelit akademik i kategorisë "Profesorë" ose "Lektorë" dhe mund të jetë njëkohësisht Drejtues i një prej departamenteve të Fakultetit përkatës.





malora premunt / gjëra të mëdha na presin



### Neni 36

#### Përgjegjësi i grupit mësimor

1. Përgjegjësi i grupit mësimor është përgjegjës për konsultimin e lëndëve të përafërta brenda një departamenti, për të garantuar cilësinë e programeve të lëndëve, brenda ekspertizës së tij, në përputhje me kriteret, standardet dhe procedurat e UET, si në aspektin përmbajtësor, ashtu edhe në atë metodologjik. Ai mund të jetë njëkohësisht koordinatori i programit/programeve të studimit më pranë fushës së grupit mësimor.
2. Përgjegjësi i grupit mësimor propozohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe emërohet nga Dekani për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Përgjegjësi i grupit mësimor shqyrton dhe miraton programet e lëndëve përkatëse (syllabuset), monitoron cilësinë e hartimit të detyrave dhe tezave të provimeve, si edhe përmbush detyra të tjera në përputhje me përcaktimet në aktet rregulatore përkatëse.

## KREU IV

### ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

#### Neni 37

##### Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të UET, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Bordi i Administrimit përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të "UET" SHPK, e cila gjithashtu emëron edhe Kryetarin ndërmjet anëtarëve.
3. Anëtarët e Bordit të Administrimit emërohen për një mandat tre vjeçar, me të drejtë riemërimi.
4. Bordit të Administrimit mbledhet periodikisht, së paku 1 herë në vit.
5. Mbledhja e Bordit të Administrimit konsiderohet e vlefshme nëse në të marrin pjesë të paktën 2/3 të anëtarëve dhe merr vendime për çështje brenda kompetencave të tij me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të të gjithë anëtarëve.
6. Bordi i Administrimit ruan të drejtën e vendimmarrjes për çështje të zhvillimit institucional dhe qëndrueshmërisë së UET dhe zgjidh çdo mosmarrëveshje dhe/ose konflikt të mundshëm në ushtrimin e kompetencave të tij në përputhje me këtë Statut.
7. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit mbaron para kohe:
  - me kërkesën e tij;
  - kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - për shkelje të rënda të ligjit;
  - për shkelje të rënda ose të përsëritura të etikës;
  - në rastin e ndryshimit të raporteve të përfaqësimit në organin drejtues;
  - kur humbet zotësinë juridike për të vepruar.

#### Neni 38

##### Funksionimi i Bordit të Administrimit

1. Bordi i Administrimit ka këto funksione:
  - a) garanton qëndrueshmërinë financiare të UET dhe përmbushjen e misionit të tij, duke monitoruar zbatimin e planit financiar;
  - b) jep mendim për projekt rregulloren e institucionit;
  - c) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përçillet Senatit Akademik;



- d) miraton rregulloren financiare të UET, duke përcaktuar rregullat dhe procedurat që ndiqen për hartimin dhe zbatimin e buxhetit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- e) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të UET dhe monitoron zbatimin e tij përmes kërkesës së llogarisë ndaj Administratorit, duke vendosur mënyrën dhe frekuencën e raportimit;
- f) përcakton rregullat dhe destinacionin për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- g) i delegon Administratorit të UET kompetenca të caktuara për ndjekjen e çështjeve konkrete brenda fushës së tij të kompetencës.
- h) cakton kriteret dhe procedurat për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në përcaktimet ligjore dhe aktet rregullatorë të UET;
- i) Shqyrton për miratim propozimet e administratorit për strukturën që mbështet veprimtarinë administrative e financiare dhe numrin e personelit administrativ;
- j) përzgjedh projektet kërkimore-shkencore që do të përfitojnë financim. Kriteret dhe mënyra e financimit përcaktohet me rregullore të veçantë.
- k) emëron dhe shkarkon Administratorin e Institucionit me propozim të Asamblesë së Përgjithshme të "UET" SH.P.K.
- l) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së UET, të hartuar nga Rektori.
- m) miraton planin strategjik të zhvillimit të UET, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik, dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- n) miraton strukturën e përgjithshme të UET dhe përcakton numrin e personelit akademik dhe ndihmës akademik për të gjitha nivelet;
- o) Përcakton strukturën e pagave të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
- p) vlerëson paraprakisht dhe/ose propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- q) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njëjësive përbërëse të UET;
- r) Miraton kriteret e propozuara nga administratori për administrimin e burimeve financiare dhe materiale;
- s) Monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit nëpërmjet auditimit të brendshëm.
- t) Miraton paraprakisht emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njëjësive kryesore nga Administratori i UET.
- u) Ngre komisione e grupe pune për çështje dhe veprimtari të veçanta në kompetencë të tij.
- v) Miraton shpërblimin e komisioneve të përhershme apo të përkohshme, shpërblimin e anëtarëve të tij, si dhe anëtarëve të Senatit, trajtimin e veçantë financiar për personelin ndihmës akademik dhe administrativ të vlerësuar shumë mirë, si dhe shpërblime për punë të ndryshme, të zhvilluara jashtë funksionit të tyre, nga ana e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të UET.
- w) Miraton paraprakisht kuotat e pranimit të studentëve të rinj për çdo vit akademik.
- x) Miraton paraprakisht propozimet për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit, ose mbylljen e tyre.
- y) Shqyrton dhe vendos me propozim apo kërkesë të Administratorit të "UET" për trajtimin specifik të rasteve/çështjeve, përtej përcaktimeve në aktet e miratuara më parë nga Bordi i Administrimit, në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 80/2015 dhe aktet e brendshme të



maiora pramunt / gjëra të mëdha na presin



UET.

### Neni 39


#### Administratori i UET

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të UET. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë, dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Asamblesë së Përgjithshme të "UET" SH.P.K.
2. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
3. Ai është përfaqësues ligjor i UET për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatorë të UET.
4. Në përzgjedhjen e Administratorit të UET merren parasysh kriteret e mëposhtme:
  - a) Kompetencat profesionale;
  - b) Cilësitë personale (si ndershmëria, korrektesa, serioziteti, përgjegjshmëria, etj.);
  - c) Eksperienca e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt;
  - d) Niveli i kualifikimit;
  - e) Aftësitë drejtuese dhe etika;
  - f) Aftësitë komunikuese dhe të punës në grup;
  - g) Rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm.
5. Administratori kryen këto funksione dhe ka këto përgjegjësi:
  - a) harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
  - b) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimit të tyre;
  - c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të UET në strukturat e varësisë së tij;
  - d) zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik sa i takon çështjeve me karakter financiar dhe administrativ;
  - e) miraton paraprakisht punësimin e anëtarëve të rinj të personelit të institucionit, si edhe nënshkruan kontratat e punës të personelit administrativ.
  - f) Raporton përpara Bordit të Administrimit me kërkesë të këtij të fundit.
  - g) i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të UET, në përfundim të vitit akademik;
  - h) bashkëpunon dhe bashkërendon me strukturat dhe autoritetet e tjera të UET për çështje të administrimit të përditshëm dhe mbarëvajtjes së punës në zbatim të legjislacionit në fuqi;
  - i) bashkërendon punën me Rektorin sa i takon përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i marrëdhënieve të punës së personelit akademik.
  - j) mbikëqyr dhe administron grantet, donacionet dhe çdo fond tjetër në mbështetje të kërkimit shkencor dhe çdo fond tjetër dhe veprimtari të tjera të UET;
  - k) emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore pas miratimit të Bordit të Administrimit;
  - l) shqyrton dhe vendos sipas rastit për kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.

### Neni 40


#### Administratori i njësive kryesore

1. Administratori i njësive kryesore është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Administratori i Institucionit pas miratimit nga Bordi i Administrimit.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



2. Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha.
3. Administratori i njësisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
4. Në përzgjedhjen e Administratorit të njësisë kryesore merren parasysh kriteret e mëposhtme:
  - a) Kompetencat profesionale;
  - b) Eksperienca e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt;
  - c) Niveli i kualifikimit akademik;
  - d) Aftësitë drejtuese dhe etika;
  - e) Aftësitë komunikuese dhe të punës në grup;
  - f) Rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm;
5. Funksionet e administratorit të njësisë kryesore janë:
  - a) realizon administrimin e përditshëm financiar të njësisë kryesore;
  - b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë kryesore;
  - c) plotëson kërkesat e drejtësisë të njësisë kryesore, me qëllim pëmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
  - d) bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë kryesore për çështjet themelore të administrimit të saj.
6. Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës edhe për ushtrimin e funksioneve për njësinë bazë.

## KREU V ORGANIZIMI I STUDIMEVE

### Neni 41

#### Format e studimit

1. Forma e studimeve në UET është si rregull me kohë të plotë, të shprehura në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas standardeve të zonës europiane të studimeve.
2. Programet e studimit në UET normalisht ofrohen në gjuhën shqipe. Programet e studimit mund të ofrohen dhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian, sipas përcaktimit në aktin përkatës të hapjes.
3. UET mund të ofrojë edhe programe studimi me kohë të zgjatur, konform legjislacionit në fuqi.

### Neni 42

#### Programet e studimit

1. UET, mbi bazën e licencimit dhe akreditimit të akorduar, ofron programe me karakter profesional, si dhe programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve universitare.
2. Programi i studimit propozohet, hartohet dhe rishikohet me kërkesë të Departamentit përgjegjës për programin e studimit.
3. Propozimi për hapjen, rishikimin apo mbylljen e një programi studimi shqyrtohet në Departament dhe nga Zyra e Kurrikulave dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit e më pas në Senat, vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht pëlqimin e Bordit të Administrimit.
4. Plani mësimor për çdo program studimi, konsultohet në mënyrë të herëpashershme me Bordet e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, dhe ai mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.
5. Çdo program studimi rregullohet me rregullore mësimore të veçantë.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



6. UET shpall publikisht, kuotat dhe kriteret e pranimit, programet e hapura dhe ato të akredituara të studimeve, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.

#### Neni 43

##### Programet me karakter profesional

1. UET ofron programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, të cilat mund të jenë me kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike, me përkatësisht 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimit të kryer.
3. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren përkatëse të UET për transferimin e studimeve, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve.

#### Neni 44


##### Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Programet e ciklit të parë të studimit organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.
2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Pragu i notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome, përcaktohet në rregulloren e UET.
3. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer.
4. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kriteret shtesë të vendosura nga UET.

#### Neni 45

##### Programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit "Master i shkencave", "Master i Arteve", "Master profesional" dhe programet e integruara të ciklit të dytë.
2. Programet e studimit "Master i shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Ato realizohen në:
  - a. programe me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;
  - b. programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike.
3. Studimet e ciklit të dytë "Master i shkencave" / "Master i Arteve" përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i shkencave" në fushën e arsimit të kryer, ose "Master i Arteve" për programet në fushën e arteve.
4. Programet e studimeve "Master profesional" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë "Master profesional" përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master profesional" në fushën e arsimit të kryer.
5. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret sipas legjislacionit në fuqi dhe kriteret e pranimit të vendosura nga UET.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



6. Pranimi në programet e integruara të studimeve është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kriteret shtesë të vendosura nga UET.
7. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen në rregulloren mësimore të programit të studimit. Kriteret miratohen në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi dhe këtij Statuti. Ato bëhen publike.

#### Neni 46

##### Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve "Master ekzekutiv", programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës.
2. Programet e studimeve "Master ekzekutiv" ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma "Master ekzekutiv" në fushën e arsimit të kryer.
3. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se dy vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite. Ato përmbyllen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet "Diplomë specializimi" në fushën përkatëse të programit të studimit.
4. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësi bazë ose njësi kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor". Kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor përcaktohen me rregullore të veçantë.
5. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën "Master i shkencave" ose "Master i arteve" dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara në UET në rregullore të veçantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe këtë Statut. Kandidatët duhet gjithashtu të plotësojnë kriterin e njohjes së njëres prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Në rastet kur kandidati ka përfunduar një program studimi të realizuar në njërin nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri. Të gjitha kriteret e pranimit bëhen publike nga UET dhe i përcillen QSHA-së, si dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

#### Neni 47

##### Studimet e Doktoratës

1. Studimet e doktoratës ofrohen në kuadër të projekteve kërkimore-shkencore dhe zhvillimit që hartohen nga UET për këto studime.
2. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
3. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim me një institucion tjetër të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucionit bashkëpunues.
4. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësi bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



5. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohet.
6. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar" dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.
7. Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, SHBA-ve dhe Kanada-së, bashkudhëheqësi në institucionin pritës mund të jetë me gradën shkencore "Doktor".

#### Neni 48

##### Programet e përbashkëta të studimit

1. UET është i hapur për të realizuar programe të përbashkëta studimi në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit.
2. Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit.
3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.
4. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, UET mund të zbatojë standarde të ndryshme nga ato shtetërore.
5. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet në përputhje me aktet rregullatore të UET dhe me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

#### Neni 49

##### Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. UET mund të ofrojë programe të studimit të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, në shërbim të plotësisimit, thellimit dhe konsolidimit të njohurive për kualifikim të mëtejshëm.
2. Struktura e këtyre programeve, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen në bashkëpunim me ministrinë e linjës përkatëse të fushës së programit, sipas kuadrit ligjor përkatës, dhe bëhen publike nga njësi kryesore.
3. Në përfundim të studimeve lëshohet certifikata përkatëse, e cila regjistrohet përpara lëshimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 50

##### Kërkimi Shkencor

1. UET kryen veprimtari kërkimore shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese të cilat realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara nga organet kompetente. Fushat, drejtimit, vëllimi i punës dhe afatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore përcaktohen bazuar në fushat prioritare të zhvillimit kombëtar, në programet e ofruara si dhe në dokumentet strategjike të kërkimit shkencor në UET.
2. UET garanton integritimin e veprimtarisë kërkimore në atë të mësimdhënies. Veprimtaria kërkimore-shkencore, që kryhet në UET, synon të mbështetë zhvillimin e vendit dhe rritjen e cilësisë së arsimit.
3. Veprimtaria kërkimore shkencore në UET si dhe vlerësimi saj rregullohet në përputhje me aktet rregullatore të UET.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



#### Neni 51

##### Transferimet dhe Njohja e periudhave të studimit

1. UET ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij apo nga dhe në institucione të ndryshme të arsimit të lartë.
2. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.
3. Transferimet në UET lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.
4. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në Rregulloren e UET dhe rregulloren e veçantë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi për njohjen e krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në UET, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga departamenti, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### Neni 52

##### Viti akademik dhe frekuentimi i procesit mësimor

1. Studimet në UET zhvillohen në vite akademike. Viti akademik organizohet në semestra.
2. Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar, e cila përcaktohet bazuar në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin, dhe specifikohet në rregulloren e institucionit.

#### Neni 53

##### Diplomimi

1. Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare me UET, fiton të drejtën e pajisjes me diplomën përkatëse.
2. Elementet përbërës, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin hartohen në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Forma e diplomës, elementet e sigurisë, si dhe elemente të tjera të saj miratohen me vendim të Senatit Akademik.
3. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, si edhe ato të ciklit të tretë "Master ekzekutiv" shoqërohen me suplementin e diplomës. Procedurat për përgatitjen, certifikimin, administrimin dhe lëshimin e suplementit të diplomës përcaktohen në rregulloren e institucionit.
4. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës hartohet në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe miratohet nga Senati Akademik.
5. Diploma nuk mund të lëshohet dublikatë. Ajo jepet vetëm një herë. Suplementi i diplomës me kërkesë të personit të interesuar mund të lëshohet dublikatë nga sekretaria mësimore, me shënimin kopje e origjinalit. UET, me kërkesë të personit të interesuar, mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me bojë teknike: nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori dhe vuloset me vulën e UET.
7. Diploma konsiderohet e vlefshme vetëm pas akreditimit të programit përkatës të studimit dhe akreditimit institucional dhe pasi ajo regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



## KREU VI PERSONELI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

### Neni 54


#### Personeli i UET

1. Personeli i UET përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmësakademik dhe personeli administrativ.
2. Personeli i UET mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.
3. Personeli punësohet sipas formave të parashikuara në këtë statut dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore të aplikueshme. Kontrata e punës lidhet mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe në Kodin e Punës, i ndryshuar.
4. Të drejtat dhe detyrimet e personelit, përcaktohen në këtë statut, si edhe në kontratën e lidhur mes tij dhe UET, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
  - i. Të drejtat kryesore janë:
    - a. Të përfitojë pushim vjetor të pagueshëm, si edhe pushime të tjera, në përputhje me përcaktimet në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e lidhur me UET.
    - b. Të rrisë aftësitë profesionale dhe/ose akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim.
    - c. Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me kontratën e punës.
    - d. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e UET, në përputhje me statutin dhe aktet rregulluese të institucionit.
    - e. T'i drejtohet me ankesë Këshillit të Etikës nëse i është cënuar liria akademike, dinjiteti profesional apo ka një qëndrim jo etik ndaj tij.
  - ii. Detyrimet kryesore janë:
    - a. të njohë, të respektojë dhe të zbatojë këtë statut, rregulloren e institucionit dhe aktet rregulluese të veprimtarisë së UET, të publikuara në arkivën elektronike të UET.
    - b. të mbrojë me besnikëri interesat e ligjshme të UET dhe të mos angazhohet në asnjë veprimtari në dëm të interesit apo reputacionit të institucionit.
    - c. të përmbushë personalisht me kujdes, korrektësi dhe ndershmëri detyrat e tij, në bazë të kontratës së punës me UET, akteve rregulluese të institucionit dhe udhëzimeve përkatëse.
    - d. të respektojë normat e etikës, moralit dhe të mirësjelljes me kolegët, studentët dhe drejtuesit e institucionit.
    - e. të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave që i ngarkohen, me përjashtim të pagës dhe privilegjeve të tjera, të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe aktet e brendshme rregulluese të UET.
    - f. t'i nënshtrohet vlerësimit periodik të performancës dhe përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në kontratën e punës dhe aktet rregulluese të UET.

### Neni 55

#### Personeli akademik dhe statusi i tij

1. Personeli akademik gëzon status të veçantë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si edhe në aktet rregullatorë të UET.
2. Personeli akademik në UET kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UET, këshillim për studentët, tutoriat si dhe veprimtari të tjera.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



3. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.
4. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në UET përcaktohet nga aktet rregullatorë të UET.
5. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 2 , të këtij neni, përcaktohen në aktet rregullatorë të UET.
6. Personeli akademik i punësuar në UET, duhet të zbatojë Kodin e Etikës, Kodin e Integritetit Akademik, këtë statut si dhe aktet e tjera rregullatorë të UET.
7. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë, nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Ai mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe të rektorit, si dhe në marrëveshje mes institucioneve.

#### Neni 56

##### Personeli akademik dhe kategoritë

1. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Personeli akademik në UET, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
  - a) profesorë;
  - b) lektorë;
  - c) asistent-lektorë.
2. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Kjo kategori, në rastet e angazhimit me kohë të plotë, punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar. Personelit akademik, që mban titullin "Profesor", pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë përkatëse dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli "Profesor Emeritus".
3. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas filimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë statut. Kjo kategori, në rastet e angazhimit me kohë të plotë, punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
4. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i shkencave" dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.

#### Neni 57

##### Personeli akademik, punësimi dhe vlerësimi

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik përcaktohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e saj dhe miratohen nga Rektori, në përputhje me përcaktimet në legjisllacionin në fuqi dhe këtë statut dhe aktet rregullatorë të UET. Kërkesat për shtimin e numrit të personelit akademik me kohë të plotë të njësisë bazë duhet të marrin miratim paraprak edhe nga Bordi i Administrimit.
2. Kriteret e konkurrimit, dokumentacioni i kërkuar dhe afati për aplikim publikohen në masmedia.
3. Seleksionimi paraprak realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila i kalon çdo Departamenti kandidaturat që plotësojnë kriteret e konkurrimit dhe që kanë profil akademik në përputhje me nevojat e përcaktuara nga Departamenti për personel të ri. Departamentet përzgjedhin kandidatët





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- që do të kalojnë në fazën e intervistës. Në çdo rast, eliminimi i kandidatëve nga listat paraprake duhet të shoqërohet me argumentimin përkatës.
4. Zhvillimi i konkursit (intervista): Personeli akademik përzgjidhet me konkurrim pas shqyrtimit nga një Komision Rekrutimi, i cili ngrihet me urdhër të Rektorit në nivel Fakulteti, kryesohet nga Dekani i Fakultetit dhe ka në përbërje të paktën një përfaqësues të Bordit të Administrimit, ose anëtar të deleguar prej tij. Anëtar i Komisionit të Rekrutimit është edhe Drejtuesi i Departamentit/Qendrës së Kërkimit dhe Zhvillimit për kandidatët e njësisë përkatëse.
  5. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës, të tillë si:
    - a) Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar, si dhe karriera profesionale jashtë auditorit;
    - b) Niveli i kualifikimit akademik (grada/titulli);
    - c) Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore;
    - d) Rezultatet akademike të kandidatit në studimet e kryera;
    - e) Aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me objektivat shkencore të UET-it;
    - f) Aftësitë komunikuese dhe etika;
    - g) Objektivat e tij afatmesëm dhe afatgjatë në karrierën akademike e shkencore;
    - h) Rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm;
    - i) Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;
    - j) Paraqitja gjatë intervistës përpara Komisionit të Rekrutimit;
    - k) Paraqitja gjatë leksionit të hapur para Departamentit përkatës (kur aplikohet).
  6. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë nga secili anëtar i Komisionit të Rekrutimit. Në përfundim të konkursit, Komisioni i Rekrutimit del me vendim për përzgjedhjen e kandidatëve që i propozohen Rektorit për t'u punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme.
  7. Mbështetur në rezultatet e konkursit, Rektori nxjerr vendim për miratimin e kandidatëve të përzgjedhur. Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek procedurat për njoftimin dhe punësimin e kandidatëve fitues.
  8. Personeli akademik i ftuar punësohet me kontratë për periudha të shkurtra kohore, me kohë të plotë ose të pjesshme, sipas nevojave të njësisë bazë për veprimtari mësimdhënies ose kërkimore – shkencore. Angazhimi i personaliteteve, studiuesve apo artistëve, vendas ose të huaj, si personel i ftuar bëhet me propozim të njësisë bazë, miratim paraprak të Bordit të Administrimit dhe miratim përfundimtar të Rektorit.
  9. Personeli akademik i nënshtrohet në mënyrë periodike, trajnimeve, testeve dhe vlerësimeve, të përcaktuara specifikisht në aktet rregullatorë të UET. Për këtë qëllim, Rektori ngre një komision *ad-hoc*, për vlerësimin e performancës.

#### Neni 58

##### Viti sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë "Lektor" dhe "Profesor" me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik. Për të përfituar këtë të drejtë, anëtari i personelit prezanton të dhënat për programin dhe/ose projektin e kërkimit që do të zhvillojë dhe nevojitet të marrë miratimin e Departamentit, Dekanatit përkatës dhe Bordit të Administrimit.
2. Në rast të miratimit të shkëputjes, anëtari i personelit akademik nënshkruan një marrëveshje me UET, në të cilën përcaktohen termat konkretë juridikë dhe financiarë, afati i shkëputjes, si edhe produkti kërkimor shkencor apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet pas rikthimit.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



#### Neni 59

##### Personeli ndihmës akademik

1. Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor, këshillim për studentët dhe detyra administrative. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit dhe ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme
3. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të UET në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në aktet e brendshme të UET.
4. Personeli ndihmës akademik përzgjidhet me konkurrim në përputhje me aktet rregullatorë të UET.
5. Personeli ndihmës akademik i nënshtrohet vlerësimit periodik të kryer në fund të vitit akademik. Për këtë qëllim, Rektori ngre një komision ad-hoc, për vlerësimin e performancës.

#### Neni 60

##### Personeli administrativ

1. Personeli administrativ kryen veprimtari administrative në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor në institucion, sipas detyrave të përcaktuara, si dhe shërbimeve për zhvillimin e UET. Ai ndihmon në realizimin e misionit të UET.
2. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të UET.
3. UET përcakton në aktet e veta rregullatore, procedurat e vlerësimit të punës së personelit administrativ, politikat e motivimit, shpërblimit, zhvillimit e trajnimit të tij, si edhe procedurat për masat disiplinore.
4. Personeli administrativ ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.
5. Personeli administrativ përzgjidhet me konkurrim pas shqyrtimit nga një komision rekrutimi dhe miratohet nga Administratori i UET, i cili nënshkruan kontratat individuale të punës. Personeli administrativ i nënshtrohet vlerësimit periodik, të kryer në fund të vitit kalendarik nga komisioni përkatës i vlerësimit të performancës, i ngritur me urdhër të Administratorit të UET.

#### KREU VII

#### SHPËRBLIMET DHE MASAT DISIPLINORE

#### Neni 61


##### Shpërblimet

1. Shpërblimet për personelin akademik dhe ndihmësakademik jepen për kontribut të dallueshëm në procesin e punës, me propozim të Rektorit dhe miratim të Administratorit të UET.
2. Shpërblimet për personelin administrativ jepen për kontribut të dallueshëm në procesin e punës me propozim të eprorit direkt dhe miratim të Administratorit të UET.
3. Parimet e motivimit dhe promovimit të personelit përcaktohen me dokument të veçantë.

#### Neni 62

##### Ekselencia

1. UET përmes akordimit të çmimeve të ekselencës synon të evidentojë, promovojë dhe shpërblejë performancën e shkëlqyer.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



2. Çmimet që ofrohen janë:
  - a) Anëtari i personelit akademik më i mirë i vitit, që jepet nga Presidenti;
  - b) Studenti më i mirë i vitit, që jepet në nivel Fakulteti nga Rektori;
  - c) Punonjësi më i mirë i vitit, që jepet nga Administratori i UET.

#### Neni 63

##### Masat disiplinore

1. Masat disiplinore merren ndaj anëtarëve të personelit akademik, autoriteteve drejtuese, personelit ndihmës akademik dhe personelit administrativ në rastet e thyerjes së Kodit të Etikës dhe parashikimeve të Kontratës së Punës. Masat disiplinore merren nga Rektori ose Administratori i UET, në varësi të llojit të shkeljes disiplinore të evidentuar dhe/ose kategorisë së personelit që e ka kryer.
2. Masa disiplinore u jepen edhe studentëve të regjistruar në UET, të cilët nuk respektojnë detyrimet e përcaktuara në këtë statut, thyejnë Kodin e Etikës dhe parashikimeve të Kontratës së Studentit. Këto masa jepen me vendim të Rektorit me propozim të Këshillit të Etikës.
3. Llojet e masave disiplinore, procedurat për dhënien e tyre, procedurat e ankimimit, si dhe shlyerja e tyre, përcaktohen në rregulloren e brendshme, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.


#### KREU VIII

##### STUDENTËT

#### Neni 64

##### Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në UET. Ky status humbet me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse, si dhe në rastin e çregjistrimit të studentit nga UET.
2. Studenti mund t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato, në përputhje me rregullat e përcaktuara në aktet rregullatorë të UET dhe kuadrin ligjor në fuqi.
3. Studenti ka të drejtë:
  - a) të ndjekë të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë regjistruar;
  - b) të përdorë infrastrukturën, që UET vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga ai;
  - c) të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes së UET, në përputhje me legjislacionin dhe statutin e UET;
  - d) të shprehë vlerësimin e vet për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në UET;
  - e) të nënshkruajë kontratë shërbimi, në momentin e regjistrimit në UET.
  - f) të sigurohen nga UET, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe Ministrit të Financave.
  - g) të zgjedhë dhe të zgjidhen në Këshillin e Studentëve dhe organet e institucionit, në përputhje me legjislacionin dhe statutin e UET;
  - h) të transferojë kreditet/studimet nga universitete të tjerë në UET dhe anasjelltas;
  - i) të jetë të barabartë, por të ndryshëm;
  - j) të organizohet në formën e Klubeve studentore, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së tyre në procesin akademik dhe të kërkimit shkencor;
  - k) të organizohet lirisht në grupime me karakter social, ekonomik, kulturor, sportiv dhe akademik;
  - l) të pajiset me Kartën e Studentit.
4. Studenti ka për detyrë:





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- a) të zbatojë rregullat e përcaktuara nga UET;
- b) të respektojë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
- c) të paguajë tarifën e shkollimit dhe tarifa për shërbime të tjera të aplikueshme në UET;
- d) të respektojë Kodin e Etikës, Statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të UET,
- e) të ndjekë rregullisht seminarët dhe orët e tjera që janë të detyrueshme sipas programit të studimit;
- f) të marrë pjesë në veprimtaritë akademike.

#### Neni 65

##### Këshilli i Studentëve dhe pjesëmarrja në qeverisjen e UET

1. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore, të UET, si edhe në nivel kombëtar.
2. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në UET, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UET.
3. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Me një rregullore të veçantë përcaktohen procedurat për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve.
4. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë.
5. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes për UET, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.
6. UET mbështet këshillat e studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë projekte të tyre.

#### Neni 66


##### Bursat për studime

1. UET ofron disa lloje bursash studimi, të plota ose të pjesëshme, si:
  - a) Bursa e Ekselencës
  - b) Bursa Talenti
  - c) Bursa "Pashko"
2. Kriteret, procedura e aplikimit dhe e akordimit të bursave dhe kushtet e zbatimit të tyre përcaktohen me rregullore të veçantë.
3. Bursat akordohen nga Komisioni i Përhershëm i Dhënies së Bursave, i cili ngrihet nga Administratori i UET.

#### Neni 67

##### Dokumentacioni i procesit mësimor dhe i të dhënave të studentëve

1. UET mban në formë të shkruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit:
  - a) regjistrin themeltar të studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UET;
  - b) regjistrin e arritjeve akademike, që është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në UET;
  - c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, që është dokumenti që vërteton emëtimin e tyre nga UET.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



2. Regjistrat shpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së UET. Regjistrat plotësohen edhe në formë elektronike.
3. UET ruan të dhënat personale të studentëve bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo nënkupton që përpunimi i të dhënave personale bëhet në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme.
4. Parimet bazë ku bazohet përpunimi i të dhënave personale nga UET-i janë ato të sigurisë së informacionit, konfidencialiteti, integriteti, disponueshmëria dhe përditësimi i të dhënave personale.
5. Të dhënave personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të universitetit.

## KREU IX FINANCIMI

### Neni 68

#### Burimet e financimit


1. UET është institucion jo publik i arsimit të lartë me vetëfinancim. Ai përcakton për çdo fillim viti akademik projektbuxhetin përkatës të institucionit të ndarë në fakultete të cilin e miraton sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut. Burimet financiare të UET ndahen në parësore dhe dytësore.
2. Burimet parësore të UET janë Financimet nga Shoqëria tregtare "UET" SHPK, ku përfshihen edhe të ardhurat nga tarifat e studimit dhe shërbime të tjera.
3. Burimet dytësore të UET janë:
  - a) të ardhura nga shërbime që UET ofron për të tretët;
  - b) donacione nga sektori publik;
  - c) donacione nga sektori privat;
  - d) donacione nga shoqëria civile;
  - e) donacione nga subjekte ndërkombëtare;
  - f) projekte të aplikuara dhe të fituara nga UET;
  - g) çdo burim tjetër i ligjshëm;
4. Të gjitha të ardhurat nga burimet dytësore përdoren vetëm në shërbim të institucionit.
5. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohet nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucionit.
6. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave, në rastet ku UET akseson fonde publike.

## KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 69

#### Të ndryshme

1. Statuti i UET miratohet dhe ndryshohet me vendim të Senatit Akademik me shumicën e cilësuar me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pas miratimit paraprak nga Bordi i Administrimit. Më pas i dërgohet për miratim Ministrit përgjegjës për arsimin.
2. Interpretimi i këtij Statuti bëhet nga Senati Akademik, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.
3. Kur Ministri përgjegjës për arsimin nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar me ligj, statuti konsiderohet i miratuar.





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



#### Neni 70

##### Vula zyrtare dhe stema

UET ka vulën zyrtare, të thatë (në formë rrethore) dhe të njomë (në formë drejtkëndore), ku shkruhet "Universiteti Europian i Tiranës", me logon e UET që paraqet një version të stilizuar të Kullës së Sahatit të Tiranës, në ngjyrë blu të miratuar me Nr. 659/4 Prot. Datë 21.10.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe të Markave.

#### Neni 71

Në zbatim të këtij Statuti, UET harton rregulloren e institucionit, rregulloret e programeve të studimit, akte të tjera të cituara në këtë statut, ose në zbatim të legjislacionit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Këto akte depozitohen në Ministrinë përgjegjëse për arsimin sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

#### Neni 72

##### Anekset

Anekset janë pjesë përbërëse e këtij Statuti. UET rezervon të drejtën të ndryshojë anekset, duke kërkuar miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

#### Neni 73

##### Dispozita kalimtare

1. Ky Statut hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Ministri përgjegjës për arsimin e lartë në Shqipëri.
2. Statuti në fuqi, i miratuar me Urdhër të Ministrit Nr. 90, datë 28/02/2017 shfuqizohet menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti.
3. Aktet e tjera rregullatorë të UET, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja rregullatorë, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

REKTORI

Prof. Dr. Drita KRUJA





maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



## ANEKS 1 STRUKTURA ORGANIZATIVE AKADEMIKE

UET përbëhet nga 5 fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
2. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit
3. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale
4. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës
5. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.

Fakulteti Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përbëhet nga:

- a) Departamenti i Shkencave Juridike
- b) Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
- c) Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor

Fakulteti Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit përbëhet nga:

- a) Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës
- b) Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
- c) Qendra për Zhvillimin e Qendrueshëm.

Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale përbëhet nga:

- a) Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit
- b) Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve
- c) Departamenti i Arteve të Aplikuara.

Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës përbëhet nga:

- a) Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë
- b) Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit
- c) Departamenti i Inxhinierisë.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përbëhet nga:

- a) Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
- b) Departamenti i Imazherisë
- c) Qendra e kërkimeve shkencore në Shëndet Publik.

